



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorozuat Punijeno / Prodato Received / Delivery	18.05.2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br. Prot Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	2900/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.343/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.343/2022 të datës 07.04.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër Vendimit me numër 01-118/02-2454 të datës 31.01.2022 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 18.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.343/2022 e datës 07.04.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 01-118/02-2454 i datës 31.01.2022 i Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës.

A r s y e t i m

Ankuesi tani i pensionuar, me datë 07.04.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1940/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër 01-118/02-2454 të datës 31.01.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 13.04.2022 ka proceduar kërkesën për



përgjigje në ankesë në Komunën e Gjakovës, ndërsa kjo e fundit me datë 28.04.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 2471/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit se ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritore, ka administruar këto prova; Ankesën me numër të protokollit 1940/2022 të datës 07.04.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër 01-118/02-2454 të datës 31.01.2022; Kërkesën me numër 01-120/02-5369 të datës 07.03.2022 të parashtruar nga ankuesi në Komunën e Gjakovës; Listën e pagave për periudhën kohore 01.03.2020 deri me datën 31.03.2020; Vendimin e datës 21.02.2022; Vendimin me numër 01-118/02-2454 të datës 31.01.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 2057/2022 të datës 13.04.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 2471/2022 të datës 28.04.2022; Akt emërimit me numër 01112-143/19 të datës 12.03.2012; Vendimin me numër 01-118/02-2454 të datës 31.01.2022; Njoftimin me numër 01-120/01-5369 të datës 07.03.2022; Fletdorzimim e datës 07.03.2022; Aktgjykimin me numër 02171921 të datës 14.09.2021; Dëshminë lidhur me kompensimin e pagës përcjellëse për nëpunësin civil; Dëshminë e datës 31.12.2015 për kompensimit të pagës jubilarë për nëpunësin civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se është e pabazuar ankesa e ankuesit

SEPSE:

Nga shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur së ankuesi _____ ka qenë i punësuar në Komunën e Gjakovës në pozitën "Referent për Shikrestari" sipas Akt emërimit me numër të protokollit 01-112-143/19 të datës 12.03.201. Tutje, Me vendimin me numër 01-118/02-2454 të datës 31.01.2022 të Menaxheres se Burimeve Njerëzore, ankuesit i ka përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit me datë 20.02.2022, duke i njohur edhe të drejtën e kompensimit në lartësinë e një page mujore në vlerën e pagës së fundit.

Ankuesi me datë 07.03.2022 ka parashtruar kërkesë me numër protokollit 01-120/01-5369 në Komunën e Gjakovës për kompensimin e tri pagave bazë mujore përcjellëse me rastin pensionimit dhe shpërblimin jubilarë për përvojën e punës tridhjetë vite në lartësi 150% të pagës mesatare mujore duke ju referuar nenit 53 të Marrëveshjes se Përgjithshmen Kolektive të Kosovës. Në përgjigje të kërkesës së ankuesit, Menaxheri i Burimeve Njerëzore përmes shkresës me numër 01-120/01-5369 ka njoftuar ankuesin se kundër vendimit për pensionim mund të parashtrroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës sipas këshillës juridike që përmban vendimi.

Ankuesi brenda afatit ligjor paraqet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër 01-118/02-2454 të datës 31.01.2022, për shkak të cenimeve thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të ligjit material (Ligjit për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës 03/L-149, neni 90. Pika 3.1 Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të

Kosovës nenin 2,52.dhe 53. Propozon që Këshilli të aprovoj ankesë si të bazuar, të anulohj Vendimin me numër 01-118/02-2454 të datës 31.01.2022, dhe të detyroj Komunën e Gjakovës që ti kompensoi ankuesit tri pagat bazë përcjellës të fundit në shumën monetare prej 1.065.45 euro, dhe kompensimin në lartësi prej 150% të pagës mesatare mujore në emër të shpërblimit jubilar për përvojën e punës në shumën prej 589.55 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme monetare prej 1.654.95 euro.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesit dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014, ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhën jo më shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017. Andaj, mbi këtë bazë Kolegji konstaton së janë të pa bazuara pretendimet ankimore të ankuesit të ngritura në ankesë, sepse ankuesi ka arritur moshën e pensionimit me datë 20.02.2022 respektivisht në kohën kur nuk është e aplikueshme Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës.

Po ashtu, Kolegji nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka gjetur se në bazë të kartelës së nëpunësit, organi i punësimit ankuesit i ka bërë kompensimin e një page mujore të njëhershme (pagës përcjellëse) me rastin e pensionimit në vlerën e pagesë së fundit, gjegjësisht 305.00 euro, rrjedhimisht bazuar në këtë konstatim rezulton se Komuna e Gjakovës ka vepruar në pajtim me nenin 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitat e nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë i cili përcakton që: *"Paragrafi 1. Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit". Paragrafi 2. Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit"*, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit për kompensimin e tri pagave bazë përcjellës me rastin e pensionimit është i pa bazuar..

Përkitazi me pretendimin e ankuesit për kompensimin e pagës së tretë jubilarë, Kolegji në bazë të dëshmive të lëndës, ka konstatuar se ankuesit në dhjetor të vitit 2015 i është bërë kompensimi i një page jubilarë për dhjetë vjet përvojë punë në vlerën e 25 % të pagës mesatare në shërbimin civil respektivisht në vlerën 93.50 Euro, kështu që nisur nga ky konstatim rrjedhë së organi i punësimit ka vepruar në pajtim me nenin 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe nenin 21 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë ku përcaktohet se : *"Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjet.ësh*



pune". Mbi këtë bazë dhe nisur nga konstatimi se ankuesit i është bërë kompensimi i shpërblimit jubilar në vitin 2015, rrjedhë se në kohën e pensionimit të ankuesit nuk janë plotësuar gjithsej 10 vite tjera të përvojës së punës, kështu që pretendimi i ankuesit për kompensim të shpërblimit jubilar të tretë është i pabazuar.

Siç u tha me sipër, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS Lënda me numër A.nr.343/2022

Ilire Mehmeti Shaqiri


Procesmbajtëse



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës ;
- Menaxherit të Personelit në Komunën e Gjakovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.